

## ÇELO HOXHA

### ÇARJA E BLOKUT KOMUNIST DHE PRISHJA E SHQIPËRISË ME BASHKIMIN SOVJETIK

Vizita e Hrushovit në Shqipëri u prezantua me pompozitet nga shtypi shqiptar, por kohët e mira të miqësisë me Bashkimin Sovjetik e kishin kaluar pikun e tyre. E planifikuar për vitin 1958, vizita u shty, nga ana e sovjetikëve, dhe u bë në një kohë që i vlente më shumë Hrushovit sesa shqiptarëve, të cilët kishin nisur tashmë të bënin lojë të dyfishtë në marrëdhëniet me fuqitë brenda Kampit Socialist. Vizita, të cilën udhëheqja komuniste e Shqipërisë nuk nguroi ta cilësonte “një kontribut tjetër në forcimin e unitetit dhe kompaktësisë së kampit socialist”,<sup>1</sup> Hrushovit i interesonte për lojën e madhe ndërkombëtare, sepse e prezantonte Kampin Socialist të unifikuar dhe BS të fortë, por drejtuesit e Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH), pavarësisht entuziazmit propagandistik, kishin tjetër gjë në mendje. Në kohën që Hrushovi ndodhej në Shqipëri, Tiranën e vizitoi një delegacion ushtarak kinez i nivelit të lartë, i kryesuar nga ministri i Mbrojtjes Kombëtare, Pin De Huaj. Ndërsa Hrushovi paralajmëronte nga Tirana vendet kapitaliste se, nëse do të guxonin të preknin kufijtë e Shqipërisë, ata do të përballëshin “me gjithë forcën e kampit të madh socialist”,<sup>2</sup> regjimi shqiptar, përmes gazetave të tij, brohoriste “Rroftë miqësia e vllazërimi i Ushtrisë Popullore Shqiptare e Kineze!”<sup>3</sup> Fakti që dy delegacionet u mbajtën të veçuar dhe kryetarët e tyre u takuan, ka autorë që e komentuan si shenjë të një politike të dyfishtë të Tiranës.<sup>4</sup>

#### **Mbledhja e Bukureshtit dhe kriza kino-sovjetike**

Më 4 qershor 1960, sovjetikët propozuan që, pas Kongresit III të Partisë Punëtore të Rumanisë (PPR), të mblidhej në Bukuresht

<sup>1</sup> “Një dokument tjetër i miqësisë dhe unitetit tonë”, në *Luftëtari*, Tiranë, 4 qershor 1959, f. 1.

<sup>2</sup> Po aty, f. 1.

<sup>3</sup> Parulla në kokën e faqes që i kushtohet delegacionit kinez në gazetën e Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë, në *Luftëtari*, Tiranë, 28 maj 1959, f. 3.

<sup>4</sup> Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit, 1998, f. 363.

konferenca e partive komuniste e punëtove të vendeve socialiste, për shkëmbim mendimesh në lidhje me gjendjen ndërkombëtare. PPSH pranoi dhe i bëri të njohur Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (PKBS) përbërjen e delegacionit që do të kryesohej nga Enver Hoxha, por, një ditë pasi shqiptarët kthyen përgjigje, sovjetikët lajmëruan për shtyrjen e mbledhjes dhe udhëheqja e PPSH vendosi që delegacionin ta kryesonte Hysni Kapo. Kur mbërriti në Bukuresht, delegacioni shqiptar u informua, nga Andropovi, anëtar i KQ të PKBS, dhe Megjoroshi, anëtar i Byrosë Politike të PPR\*, të cilët ishin caktuar nga partitë e tyre për të komunikuar me delegacionin shqiptar, për mosmarrëveshje që ekzistonin mes PKBS dhe Partisë Komuniste të Kinës (PKK), në lidhje me çështje të politikës së jashtme, çështje ideologjike dhe mënyrën e ndërtimit të socializmit. Sipas sovjetikëve, PKK vepronte në kundërshtim me Deklaratën e Moskës (1957), se ajo kishte rënë në kundërshtim me “partitë komuniste motra” që kishin nënshkruar deklaratën, dhe për këto arsye, ata propozuan, në emër të partive të tyre, që të mbahej mbledhja e anuluar e Bukureshtit mes partive komuniste dhe punëtove. Kështu, mbledhja e planifikuar fillimisht për diskutimin e çështjeve të politikës ndërkombëtare (në lidhje me botën kapitaliste), u kthye në gjyq për PKK, bazuar në një material informativ të shpërndarë nga PKBS vetëm pak orë para mbledhjes. Delegacioni kinez, i kryesuar nga Pin Çen, i quajti shpifje akuzat ndaj partisë së tyre në materialin sovjetik dhe diskutimet e disa delegacioneve që bazoheshin te ai material.<sup>5</sup>

Me ardhjen e Hrushovit në pushtet, BS kishte moderuar disa qëndrime të cilat deri atëherë kishin qenë të paprekshme për komunistët. Tashmë sovjetikët mbështesnin idenë e kalimit në socializëm me rrugë paqësore, ndërsa kinezët mendonin se koha që jetonin ishte epoka e revolucioneve dhe diktaturës së proletariatit, pasi proletariati nuk kishte ardhur në pushtet në një pjesë të madhe të botës, e cila përfshinte 2/3 e njerëzimit. Sipas kinezëve, Deklarata e Moskës i përcaktonte të dy rrugët për kalimin në socializëm, me anë të luftës dhe në mënyrë paqësore, ndaj ata donin të vazhdonin me propagandimin e të dyjave. Kinezët ishin të

\* Këtë e emër e mbajti në periudhën 1954-1965, pastaj u quajt Partia Komuniste e Rumanisë (PKR).

<sup>5</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Mbledhja e Bukureshtit, viti (më tej: V.) 1960, dosja (më tej: D.) 8, fl. 1-3. Raport mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtove.

mendimit që klasa punëtore duhej të përgatitej edhe për kryengritje të armatosur, që të mos gjendej në befasi, por të ishte e përgatitur për të marrë iniciativën e luftës, nëse, sipas tyre, borgjezia do të përdorte armët.<sup>6</sup> Enver Hoxha, duke mbështetur kinezët, këtë ide e çoi më tej pak muaj më vonë në Mbledhjen e Moskës, e njohur si Mbledhja e 81 partive. Sipas tij, heqja dorë nga lufta u hiqte popujve mundësinë të merrnin pushtetin. “Deri tashti asnjë popull, asnjë proletariat dhe asnjë parti komuniste ose punëtore s’e ka marrë pushtetin pa gjak dhe pa violencë” tha Hoxha.<sup>7</sup>

Një çështje tjetër ishte ajo e bashkekzistencës paqësore, e cila identifikohet tashmë me Hrushovin, por kinezët nuk ishin dakord që ky të bëhej parim dominues i lëvizjes komuniste, sepse, sipas tyre, rreziku i luftës ishte i pranishëm. Ata ishin dakord që popujve t’u flitej për mundësinë e evitimit të luftës, por dhe për faktin që imperialistët mund të bëheshin shkaktarë të shpërthimit të saj.<sup>8</sup> Qëndrimi kinez për bashkekzistencën paqësore ishte kontradiktor, sepse, para se ta përqafonte Hrushovi, atë parim e kishin përdorur kinezët në marrëveshje me Indinë, më 1954, fakt që përfaqësuesi kinez në Bukuresht e kujtoi si dëshmi që Kina ishte pro bashkekzistencës paqësore.<sup>9</sup> Në Mbledhjen e Moskës, sipas sovjetikëve, Mao Ce Duni kishte deklaruar që “puna është se ne duhet ta arrijmë paqen për 15 vjet. Atëherë ne do të jemi të pathyeshëm në tërë botën.”<sup>10</sup>

Një çështje tjetër ishte ajo e autoritetit brenda lëvizjes komuniste dhe ky ishte, në fakt, thelbi i gjithë mosmarrëveshjeve. BS kishte luajtur rolin e udhëheqësit brenda kësaj lëvizjeje, rol që e respektoi dhe Kina kur u bë pjesë e saj. Vendet komuniste, kur flisnin për lëvizjen ndërkombëtare, e kishin kthyer në slogan shprehjen “me Bashkimin Sovjetik në krye.” Këtë

<sup>6</sup> *Po aty*, fl. 9. Raport mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore.

<sup>7</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 38, fl. 11. Fjalimi i Enver Hoxhës në mbledhjen e partive komuniste dhe punëtore në Moskë, nëntor 1960.

<sup>8</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 8, fl. 9. Raport mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore.

<sup>9</sup> *Po aty*, fl. 10. Raport mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore.

<sup>10</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 2, fl. 87. Material informativ i PKBS për PPSH, i shpërndarë në mbledhjen e Bukureshtit.

rregull Kina e vuri në dyshim, kur, në Mbledhjen e Moskës, kundërshtoi që në deklaratën përfundimtare të përmendej Kongresi XX i PKBS.

Përfaqësuesi kinez në Bukuresht foli për kritikën e vazhdueshme që i ishin bërë Kinës dhe përmendi rezolutën e Federatës Sindikale Botërore në Pekin, fjalimin e Hrushovit në kongresin e partisë hungareze (dhjetor 1958), një fjalim të tij në Moskë, një deklaratë të agjencisë sovjetike të lajmeve TASS etj.<sup>11</sup> Hrushovi i quante kinezët ideologë të luftës së ftohtë dhe dogmatikë. Sipas raportit të Hysni Kapos, Hrushovi i kritikoi kinezët për mosvlerësim të drejtë të marrëdhënieve midis shteteve kapitaliste dhe luftën e klasave në ato vende. Ai mendonte se një pjesë e shoqërisë borgjeze i trembej luftës dhe për këtë iu referua një deklaratë të presidentit amerikan, Ajzenhauerit, që kishte thënë se po të fillojë lufta, Amerika do të vdesë. Sovjetikët mendonin, sipas Kapos, se qëndrimi i Kinës forconte botën kapitaliste, sepse, duke thënë që socializmi do të fitojë vetëm me luftë, ata tregonin mosbesim të triumfi i ideve të komunizmit dhe epërsia e sistemit socialist.<sup>12</sup>

Të gjitha vendet socialiste të Evropës Lindore, me përjashtim të Shqipërisë, mbajtën anën e Bashkimit Sovjetik në mbledhjen e Bukureshtit. Teodor Zhivkovi, kryetar i delegacionit bullgar, mbrojti politikën e bashkekzistencës paqësore të Bashkimit Sovjetik, e cila i kishte siguruar, sipas tij, “fitore të mëdha kampit tonë”, kishte treguar forcën e këtij kampi dhe i kishte detyruar “imperialistët të kalojnë në mbrojtje.” Ndërsa kinezët, sipas pikëpamjes bullgare, ishin larguar “nga praktika e marksizëm-leninizmit” dhe përpiqeshin që pozitën e tyre t’ua impononin dhe partive të tjera.<sup>13</sup> Për çekoslovakët, Bashkimi Sovjetik ishte shembull “se si duhen kryer detyrat e internacionalizmit proletar.” Ata dënuan “sjelljet dhe gabimet e shokëve kinezë,” që kishin filluar të përhapnin, me metoda “jo të drejta”, pikëpamjet e tyre.<sup>14</sup> Edhe vendet e tjera – Gjermania, Polonia, Rumania, Hungaria, mbajtën të njëjtën linjë:

<sup>11</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 8, fl. 10. Raport mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtores.

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 7, fl. 4. Procesverbal i mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtores në Bukuresht, 24-26 qershor 1960.

<sup>14</sup> *Po aty*, fl. 9. Procesverbal i mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtores në Bukuresht, 24-26 qershor 1960.

mbështetje për BS dhe kritika për Kinën.<sup>15</sup> Në raportin e tij për mbledhjen e Bukureshtit, Hysni Kapo shkruante se ishin “bërë shumë diskutime të ashpra, sidomos midis delegacionit kinez, sovjetik dhe disa delegacioneve të partive motra të vendeve socialiste të Evropës.”<sup>16</sup>

Delegacioni shqiptar, ndryshe nga ato të vendeve të tjera të Evropës Lindore, nuk doli në mbështetje të Bashkimit Sovjetik. Hysni Kapo deklaroi se nuk ishte i autorizuar të prononcohej, sepse eprorët e tij në Tiranë kishin vendosur se do të flisnin për këto çështje në mbledhjen “e ardhshme”, e cila u mbajt në nëntor, por në kohën e diskutimit të Kapos nuk ishte përcaktuar ende koha e mbajtjes së saj, dhe, sipas KQ të PPSH, duhej bërë “sa më parë.” Sipas Kapos, udhëheqja shqiptare kishte qenë në dijeni në mënyrë të përgjithshme për mosmarrëveshjet kino-sovjetike, por, duke i konsideruar “shumë të rënda [dhe], shumë të dëmshme” për “çështjen tonë të përbashkët,” ishte e mendimit që ato duhet të zgjidheshin “nëpërmjet një diskutimi, në mes të dy partive.”<sup>17</sup> Mospjesëmarrja e Enver Hoxhës në Bukuresht ngjalli dyshime, ajo u lexua si ftohje e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik.<sup>18</sup> Në fillim të mbledhjes mungonte dhe Gomulka, por ai shkoi më vonë.<sup>19</sup>

Mbledhja e Bukureshtit doli me një deklaratë, e përgatitur nga sovjetikët, ku pjesëmarrësit shprehën besnikërinë ndaj parimeve të Deklaratës së Moskës që ishin “program i luftës për paqe, demokraci dhe

<sup>15</sup> Lexo diskutimet e përfaqësuesve të tyre: *Po aty*, fl. 14-15, 16-18, 19-20, 20-21.

<sup>16</sup> *AQSH*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 8, fl. 21. Raport mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtores.

<sup>17</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 3, fl. 3-4. Fjalimi i Hysni Kapos në mbledhjen e Bukureshtit. Nicolas C. Pano e sintetizon kështu qëndrimin e delegacionit shqiptar në Bukuresht: Nuk kritikoi Kinën, sulmoi revizionizmin jugosllav, përkrahu qëndrimin e Kinës ndaj Jugosllavisë, pavarësisht presionit sovjetik. Shih: Nicholas C. Pano, *The People's Republic of Albania*, Baltimore: The Johns Hopkins Press, 1968, f. 136.

<sup>18</sup> *AQSH*, F. 14/SKR, V. 1960, D. 691, fl. 22. Relacion i ambasadorit shqiptar në Bukuresht për takimet me përfaqësues të ambasadës bullgare, 11 korrik 1960.

<sup>19</sup> Enver Hoxha nuk donte të shkonte në Bukuresht në asnjë mënyrë dhe pas vajtjes së Gomulkës aty druhej mos sovjetikët i dërgonin avion të posaçëm për ta marrë, ndaj e porositi Hysni Kapon që t’ua bëjë të qartë se mosvajtja e Hoxhës është vendim i KQ dhe ai do të shkojë vetëm në mbledhjen e “ardhshme”. *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 1, fl. 17.

socializëm.”<sup>20</sup> Në fund të mbledhjes, teksti u aprovua me unanimitet, por delegacioni kinez deklaroi, në emër të partisë së tij, se e firmosi deklaratën për hir të ruajtjes së unitetit të Kampit Socialist. Ai u shpërndau delegatëve tekstin e deklaratës të shoqëruar me vërejtjet që kishte bërë KQ i PKK, të cilat, sipas Hysni Kapos, ishin të mbështetura “plotësisht” në Deklaratën e Moskës. Vërejtjet e kinezëve nuk u aprovuan të futeshin në tekst, por ato deklaruan që rezervonin të drejtën të shpreheshin në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëtore, e cila u vendos të mbahej në Moskë, pas festës së Revolucionit të Tetorit.<sup>21</sup>

### **Shpikja e armiqve në emër të unitetit të partisë**

Enver Hoxha mendonte përtej mbledhjes së Bukureshtit që në kohën e zhvillimit të saj. Më 22 qershor, ai e porositi Hysni Kapon, t’ua bënte të qartë sovjetikëve, përmes Andropovit, se uniteti i udhëheqjes së PPSH ishte “çelik.”<sup>22</sup> Mesa duket ai e kishte marrë vendimin e prishjes me Bashkimin Sovjetik, por ende nuk e dinte kush tjetër, veç tij dhe një grupi të ngushtë bashkëpunëtorësh. Dhe kjo gjë u bë preokupimi i tij gjatë gjithë asaj vere.

Më 11-23 korrik 1960, KQ i PPSH organizoi Plenumin XVII, i cili aprovoi raportin rreth veprimtarisë së delegacionit të PPSH në Bukuresht dhe diskutoi mbi mosmarrëveshjet mes PKBS dhe PKK. Rendi i ditës ishte formal, thelbi i plenumit ishte hapi i parë i Hoxhës për të mbrojtur pushtetin personal përballë sulmeve që mendonte se do t’i vinin nga Moska. Ai nuk e kishte të lehtë të dilte kundër Bashkimit Sovjetik, por as përballë njerëzve të tij. Për gati dy dekada ai dhe bashkëpunëtorët e tij kishin ndërtuar imazhin e Bashkimit Sovjetik si vendi udhëheqës i padiskutueshëm i komunizmit ndërkombëtar dhe burimi i dijes teorike dhe praktike të tij.<sup>23</sup> Marrja e një kthese të menjëhershme ishte e vështirë

<sup>20</sup> *Po aty*, fl. 45. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 24 qershor 1960.

<sup>21</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 8, fl. 22-23. Raport mbi zhvillimin e punimeve në mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore.

<sup>22</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 1, fl. 21. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 22 qershor 1960.

<sup>23</sup> Anton Logoreci, “Albania: The Anabaptists of European Communism”, *Problems of Communism*, May 1967, f. 24. Adresa (Vizituar për herë të fundit: 30 prill 2016): <http://www.unz.org/Pub/ProblemsCommunism-1967may-00022>

dhe Hoxha e kishte parasysh këtë, kur u shpreh, se nuk kemi mosmarrëveshje ideologjike, ekonomike apo ushtarake me Bashkimin Sovjetik.<sup>24</sup> Më tej, ai u bëri thirrje anëtarëve të plenumit që nga ajo mbledhje të dilnin “të bashkuar si çeliku... me Bashkimin Sovjetik, me kampin e socializmit, me marksizëm-leninizmin.”<sup>25</sup> Hoxha vijoi me qëndrim të butë ndaj sovjetikëve, megjithëse uniteti i çeliktë, sipas tij, duhej për të mbrojtur “atdheun dhe partinë tonë,” të cilët, në fakt, nuk përballëshin me ndonjë kërcënim serioz nga jashtë Bllokut Socialist.

Plenumi ishte i mbushur me njerëz që, siç u shprehën një nga një në diskutime, ushqenin dashuri për Bashkimin Sovjetik, por, për t’u shfajësuar, shtonin se dashurinë për BS ua kishte ushqyer ose “shoku Enver”, ose “partia”, ose të dy bashkë.<sup>26</sup> Situata në PPSH ishte e paqartë dhe për faktin se para nisjes së delegacionit për në Bukuresht, Byroja Politike kishte premtuar se “si kurdoherë atje do të mbajmë pozitën e Bashkimit Sovjetik.”<sup>27</sup>

<sup>24</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 40. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960.

<sup>25</sup> *Po aty*, fl. 49. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960.

<sup>26</sup> Një pjesë e anëtarëve të plenumit e përmendën faktin që ushqenin dashuri të madhe për BS dhe këtë fakt ia atribuonin ndikimit të Enver Hoxhës. Rrapo Dervishi: “Nga dashuria që kemi për BS, sikurse na ka mësuar shoku Enver”. Vito Kapo: “Ne nën mësimet e partisë dhe të shokut Enver e duam dhe e ruajmë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe vendin e sovjetikëve, si partinë dhe vendin tonë”. Dashnor Mamaqi: “Marseli Kasheni... kur kish ardhur me rastin e 10 vjetorit të partisë sonë (1951)... tha se kam qenë në shumë vende, por një dashuri të tillë për Bashkimin Sovjetik si në Shqipëri, askund nuk e kam gjetur. Dhe këtë dashuri për Bashkimin Sovjetik e ka rrënjësuar partia jonë”. Behar Shtylla: “Ne Bashkimin Sovjetik e duam si jetën tonë, kështu na ka mësuar partia dhe shoku Enver”. *AQSH*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 73, 108, 116, 132-133. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960.

<sup>27</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 287-288. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960. Deklaratë e Liri Belishovës në një shkëmbim replikash me Enver Hoxhën. Pretendimit të saj se deklaratën e kishte të bazuar në procesverbalin e një mbledhjeje më të hershme të Byrosë Politike, Hoxha iu përgjigj: “Nuk ka thënë njeri kështu, nëse atje është shkruar kështu, e ka shkruar vetë ai që ka mbajtur procesin [verbalin]”. Më tej, Hoxha i referohet përsëri çështjes së procesverbaleve të mbledhjes dhe duke i thënë Belishovës: “Duhet të dish se deri tani anëtarët e Byrosë Politike nuk kanë punuar me procesverbale, po me një frymë revolucionare, me një besim të madh te njëri-

Hoxha e nisi diskutimin në nivel parimor, por ishte Mehmet Shehu ai që zbulonte shqetësimin e drejtuesve të PPSH, dhe që dukej i informuar për planet e Hoxhës. Nga fjala e tij kuptohej që prishja me Bashkimin Sovjetik ishte e mundshme dhe atyre që e dëgjonin iu duhej të pozicionoheshin. Ai tha se asnjë nga anëtarët e plenumit nuk duhej të mendonte se me prishjen e të dy partive do të vazhdonin marrëdhëniet mes dy vendeve. “Të mos mendojë kush se jashtë Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror mund të ketë miqësi me Bashkimin Sovjetik,”<sup>28</sup> tha ai. Mesazhi ishte i qartë, nëse dikush përjashtohej nga Byroja dhe KQ, automatikisht ishte armik. Shehu u bëri thirrje të hapur anëtarëve të plenumit të forconin unitetin rreth Enver Hoxhës.<sup>29</sup>

Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, të cilët vepronin të koordinuar, i pari bënte parimorin dhe i dyti ishte më i drejtpërdrejtë, u munduan t'i frikësonin anëtarët e plenumit me rrezikun që përfaqësonte sjellja e re e Hrushovit karshi udhëheqjes së komunistëve shqiptarë. Shehu deklaroi se anëtarët e Byrosë Politike kishin pasur presion të vazhdueshëm nga “shokët sovjetikë”, por nuk u kishin treguar anëtarëve të KQ, apo të tjerëve, “për të mos lënë asnjë grimë dyshimi në unitetin tonë me Bashkimin Sovjetik.”<sup>30</sup> Në fakt, ata e dinin se ishte shumë e vështirë që Bashkimi Sovjetik të portretizohej me terma armiqësorë tradicionalë, si Jugosllavia apo vendet kapitaliste, ndaj e vetmja zgjidhje për ta ishte të fajësonin Hrushovin dhe bashkëpunëtorët tij si të korruptuar dhe ndotës të komunizmit.<sup>31</sup> Edhe në mbarim të plenumit, Hoxha u shpreh se Bashkimin Sovjetik e duam se “ai na çliroi, se njerëzit sovjetikë u vranë për popullin tonë” dhe se PKBS “e kemi pasur dhe do ta kemi në zemër kurdoherë.”<sup>32</sup> Kështu Hrushovi u akuza si komplotist dhe antimarksist

tjetri dhe nuk kanë parë ç'fjalë ka thënë ai tjetri, këtë apo atë për të mbrojtur vijën e partisë” (*Po aty*, fl. 386). Andropovi deklaroi, në takimin e dy delegacioneve në nëntor, se Kapo i kishte thënë se Shqipëria do të mbështeste Bashkimin Sovjetik, gjë që Kapo e mohoi. Shkëmbimi u bë në prani të Hrushovit dhe Hoxhës (*Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 30, fl. 213).

<sup>28</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 164. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Diskutim i Mehmet Shehut.

<sup>29</sup> *Po aty*.

<sup>30</sup> *Po aty*, fl. 165. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Diskutim i Mehmet Shehut.

<sup>31</sup> A. Logoreci, “Albania: The Anabaptists of European ...”, f. 24.

<sup>32</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 171. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Fjala e mbylljes së plenumit nga Enver Hoxha.

për sjelljen e tij ndaj Kinës në Bukuresht, ose i pacipë që i kishte dërguar KQ të PPSH një letër të Panajot Plakut, i arratisur në Jugosllavi.<sup>33</sup> Shehu e mbylli fjalën e tij në diskutimet e plenumit me thirrjen për forcimin e “unitetit tonë rreth shokut Enver.”<sup>34</sup>

Enver Hoxha e kishte marrë vendimin e tij tashmë, mbledhja e Bukureshtit i shërbeu si një pretekst. Në plenumin e korrikut ai u shpreh se në mbledhjen e nëntorit PPSH do të mbante “qëndrimin denoncues ndaj Bashkimit Sovjetik”. Ai tha se “ne jemi përgatitur me kohë për këtë luftë,” pa e përcaktuar kohën, dhe pranoi që këtë e kishte bërë në fshehtësi me një grusht të vogël njerëzish.<sup>35</sup> Ai i paralajmëroi anëtarët e plenumit se mund të ishte e mundshme lufta. Ai tha se Tito i kishte thënë Naserit, presidentit të Egjiptit, se “në ato ditë që do të ngjasë diçka në Shqipëri... ju nuk duhet ta mbështesni Shqipërinë.”<sup>36</sup>

Plenumi i korrikut nisi kritikën ndaj Liri Belishovës, të cilat vazhduan në disa mbledhje të Byrosë gjatë verës, dhe përfunduan me përjashtimin e saj nga partia në Plenumin XVIII, në shtator. Belishova u kritikua “për gabimet e mëdha e serioze” që ajo kishte bërë gjatë qëndrimit në Kinë dhe BS, në kohën e mbledhjes së Bukureshtit. Ajo kishte vepruar “në kundërshtim me vijën e partisë” dhe nuk kishte qenë “në unitet veprimi në disa çështje të rëndësishme ideologjike e politike me të gjithë KQ të partisë”, kur, sipas raportit të shtatorit, uniteti ideologjik, ishte jetik për partinë, sidomos në një kohë kur “armiqtë dhe revizionistët modernë” kërkonin “edhe të çarat më të vogla për të goditur partinë”.<sup>37</sup>

Gjatë vizitës në Kinë, zyrtarët kinezë u folën shqiptarëve për mosmarrëveshjet që kishin me sovjetikët dhe Belishova kishte vënë në dijeni për përmbajtjen e bisedës ambasadën sovjetike në Pekin. Duke i folur delegacionit shqiptar për mosmarrëveshjet e tyre me sovjetikët

<sup>33</sup> *Po aty*, fl. 165. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Diskutim i Mehmet Shehut.

<sup>34</sup> *Po aty*, fl. 167. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Diskutim i Mehmet Shehut.

<sup>35</sup> *Po aty*, fl. 168-171. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Fjala e mbylljes së plenumit nga Enver Hoxha.

<sup>36</sup> *Po aty*, fl. 175. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Fjala e mbylljes së plenumit nga Enver Hoxha.

<sup>37</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 3, fl. 76. Raport në plenumin e KQ të PPSH mbi qëndrimin e Liri Belishovës në kundërshtim me vijën politike dhe ideologjike të PPSH.

“shokët kinezë” kishin treguar, sipas raportit “besim të madh dhe respekt të thellë për partinë tonë marksiste-leniniste.”<sup>38</sup> Vetë Belishova ishte “tronditur” nga ato që kishte dëgjuar të thuheshin kundër Bashkimit Sovjetik, siç ishte, për shembull, ajo çfarë i kishte thënë Liu Shaoçiu, që “faktori i jashtëm [Bashkimi Sovjetik] nuk ka qenë i rëndësishëm për çlirimin e Shqipërisë.”<sup>39</sup> Sovjetikët e pritën me entuziazëm Belishovën në Moskë, për shkak të qëndrimit të saj në Kinë, që sovjetikët, sipas Enver Hoxhës, e konsideronin “heroik.”<sup>40</sup>

Arsyet e veprimit të saj, Belishova i justifikoi se ishin si rrjedhojë e bindjes që kinezët nuk ndiqnin një rrugë të drejtë dhe të dashurisë së madhe të saj për Bashkimin Sovjetik dhe PKBS, siç e kishte mësuar “partia dhe shoku Enver.”<sup>41</sup> Megjithatë, gabimet e Belishovës nuk ishin as ideologjike as politike; ajo nuk kishte vënë në dyshim as doktrinën komuniste dhe as politikën e partisë së saj. Raportimi i politikanëve shqiptarë në ambasadën sovjetike më të afërt ishte rutinë prej më shumë se një dekade. Hoxha, Shehu, Belishova e të tjerë raportonin rregullisht te ambasadori sovjetik për çështje mes dy vendeve, mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, apo edhe mes vetë shqiptarëve. E shumta, veprimi i Belishovës mund të konsiderohej, nga një këndvështrim diplomatik, si jo etik. Ndaj gabimi i vërtetë i Belishovës ishte se ajo nuk ishte në dijeni të atyre që i dinin veç Hoxha, Shehu dhe Kapo. Ata kishin vendosur të prisheshin me BS dhe të kalonin nën influencën e Kinës, dhe shqetësimi i tyre ishte që ky kalim të mos krijonte të çara në radhët e tyre, të cilat mund të shfrytëzoheshin nga sovjetikët si kundërpeshë pushteti. Gabimi i vërtetë i Belishovës ishte ajo çfarë artikuloi Mehmet Sheu: “Atyre [sovjetikëve] u është lënë përshtypja se në udhëheqjen tonë ne kemi përçarje.”<sup>42</sup>

<sup>38</sup> *Po aty*, fl. 77. Raport në plenumin e KQ të PPSH mbi qëndrimin e Liri Belishovës në kundërshtim me vijën politike dhe ideologjike të PPSH.

<sup>39</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 256. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

<sup>40</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 172. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Fjala e mbylljes së plenumit nga Enver Hoxha.

<sup>41</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 256. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

<sup>42</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 110. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960.

Hoxha kishte përpara sfidën më të madhe të pushtetit të tij dhe pasiguria ishte e një shkalle po aq të madhe, ndaj ndëshkimi i njerëzve që mund të kishin dhënë, me dashje apo pa dashje, sinjale përçarjeje në drejtimin e PPSH, nuk mund të mbetej veç me një kritikë, si ajo që iu bë Liri Belishovës në Plenumin XVII. Hapat e mëtejshëm për “të forcuar unitetin e partisë” ishin, për Hoxhën, të padiskutueshëm, ndaj ato nuk duhet të vlerësoheshin në planin personal, por në prizmin e interesit të partisë. Ndëshkimi i prezantohet viktimës si një sakrificë në emër të diçkaje më të madhe se vetja e saj, qëllimi i dënimit ishte, sipas Hoxhës, vetëm forcimi i partisë. Ndëshkimi ishte një lëvizje taktike dhe politike, që, sipas Hoxhës, Belishova nuk para e kuptonte drejt.<sup>43</sup>

Për ndëshkim nuk ishte kusht të kishe bërë diçka, si në rastin e Belishovës, mund të dënoheshe, siç u dënua, nga i njëjti plenum, dhe Koço Tashko, për mendimet që ai kishte në kokë. Sipas raportit “Mbi veprimtarinë antiparti të Koço Tashkos”, mbajtur në Plenumin XVIII, Tashko, i tronditur nga “situatat”, mosmarrëveshjet e PPSH me BS, kishte krijuar “në kokën e tij, gjithfarë legjendash e fantazish”, të cilat vinin në dyshim vijën e PPSH. Qëndrimi pro kinez i plenumit të korrikut ishte, sipas raportit, një “shpikje” e Tashkos, sepse plenumi vetëm sa kishte aprovuar qëndrimin e delegacionit shqiptar në Bukuresht dhe kishte vendosur që KQ të përgatitej me kujdes për mbledhjen e nëntorit në Moskë. Tashko nuk i kishte diskutuar shqetësimet e tij me “ndonjë shok të vjetër të byrosë politike”, por e kishte parë “më të nevojshme dhe të arsyeshme” të fliste me ambasadorin sovjetik në Tiranë. Ai ishte munduar të ndërmjetësonte mes PPSH dhe PKBS, por koncepti ndërmjetës, sqaron raportin, ishte i huaj “për partinë tonë”, sepse, sipas

<sup>43</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 378. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960; Julian Birch, “Albania – The Reluctant Puppet”, *The Journal of Social, Political and Economic Studies*, (December 1977), f. 284-285. Ky autor thotë se Liri Belishova e Koço Tashko kishin marrë pjesë në një përpjekje reale për të rrëzuar Enver Hoxhën nga pushteti. Autori i referohet një artikulli të “Zërit të Popullit”, 25 mars 1962, por dokumentet arkivore shqiptare nuk e mbështesin një pretendim të tillë. Akuzat ndaj Liri Belishovës, që çuan në dënimin politik dhe administrativ të saj (internim), jo burgimit siç thotë ky autor, u bazuan në incidente shkaktuar më shumë prej mosnjohjes së tensioneve të krijuara mes udhëheqjes së ngushtë të PPSH dhe PKBS, sesa prej dëshirës së saj për të marrë kreun e partisë. Ndërsa Tashko u dënua thjesht për bindjet e tij prosovjetike.

asaj që thotë raporti, PPSH njihje veçse një ndërmjetës dhe ky ishte një entitet metafizik, “marksizëm-leninizmi.”<sup>44</sup>

Akuzat nuk ishin diçka që mund të debatoheshin, edhe argumenti edhe kundërgargumenti ishin e drejtë e drejtuesve të partisë. Kur Koço Tashko u ankua në gusht se ai ishte vendosur nën një regjim të rreptë përgjimi, me roje ngado, Hoxha e konsideroi këtë shenjë mosbesimi të Tashkos ndaj partisë, megjithëse ai ishte i vëzhguari nga partia dhe jo e kundërta.<sup>45</sup> Ndërsa, kur bëhej fjalë që ai kishte biseduar me ambasadën sovjetike në Tiranë, gjë që Hoxha e Shehu e kishin bërë rregullisht, sërish Tashko konsiderohej dyshues ndaj partisë. Me fjalë të tjera, çfarëdo që të kishte bërë apo thoshte Tashko, ai ishte etiketuar mosbesues dhe njolla nuk mund t’i hiqej, veç me ndëshkim.

Problemi i Koço Tashkos ishte se ai gjykonte i shqetësuar për fatin e Shqipërisë si vend socialist, nëse ajo prishej me Bashkimin Sovjetik, ndërsa Hoxha e Shehu e identifikonin Shqipërinë socialiste me fatin e pushtetit të tyre. Për Tashkon, Bashkimi Sovjetik ishte një konstante e pandryshueshme, ishte Shqipëria dhe vendet e tjera ato që duhet të përshtateshin me ndryshimet që bënte Moska. Tashko mendonte se Bashkimi Sovjetik duhet të ishte etaloni i qëndrimeve ideologjike, dhe qëndrimet e Moskës ndaj marksizëm-leninizmit nuk mund të viheshin në diskutim. Ai ishte i mendimit që në mbledhjen e nëntorit PKBS nuk duhej të kritikohesh për çështje ideologjike. Sipas Tashkos ekzistonte vetëm një marksizëm-leninizëm dhe ky ishte partia e Leninit, dhe, sipas tij, nuk mund të lavdërohej PKBS e të kritikohesh udhëheqja e saj, sepse ishte si të ndaje trupin nga koka.<sup>46</sup>

Ndryshe nga Liri Belishova, e cila kishte bërë diçka, Koço Tashko u ndëshkua pa bërë asgjë që mund të binte ndesh me zhvillimet e reja në raportet shqiptaro-sovjetike, por ishte i njohur për mendimet dhe ndjenjat e tij prosovjetike. Sidoqoftë, për shkak të qëndrimeve dhe ndjenjave pro sovjetike ata u panë si persona që mund të ishin dakord ose të bëheshin pjesë e ndonjë përpjekjeje që, me përkrahjen e Moskës, të synonte ndryshimin e udhëheqjes së PPSH. Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu

<sup>44</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1960, D. 3, fl. 87. Raport mbi veprimtarinë e Koço Tashkos në kundërshtim me vijën e PPSH.

<sup>45</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 209. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

<sup>46</sup> *Po aty*, fl. 194. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

kishin arritur tashmë ta identifikonin veten me partinë dhe popullin, nëse atyre u ndodhte diçka, kjo i ndodhte gjithë partisë dhe popullit. Sipas Shehut, Tashko ishte i dyshimtë sepse ai mund të kishte kaluar në mendje idenë që “kjo udhëheqje [Hoxha dhe Shehu]” duhej ndryshuar.<sup>47</sup>

Liri Belishova dhe Koço Tashko mund t’i kenë shpëtuar ekzekutimit vetëm falë presionit sovjetik.<sup>48</sup> Regjimi i Hoxhës, pavarësisht konfliktit që kishte me sovjetikët, nuk guxoi ta çonte në ekstrem ndëshkimin e tyre, por zhveshja nga funksionet zyrtare deri në përjashtimin nga partia, mjaftoi për ta bërë efektin e dëshiruar nga dyshja Hoxha-Shehu. Ndëshkimi i tyre ishte një shembull për gjithë simpatizantët e Bashkimit Sovjetik në Shqipëri, ata panë cili do të ishte fati i tyre, nëse guxonin ta shprehnin simpatinë e tyre. Nga ana tjetër, kjo i minimizonte mundësitë e sovjetikëve për të gjetur njerëz të gatshëm t’u shërbenin, nëse ata do të dëshironin të ndërmerrnin ndonjë nismë për ndryshimin e drejtuesve të PPSH dhe qeverisë në Shqipëri. Pak muaj më vonë, në Kongresin IV të PPSH (shkurt 1961), Mehmet Shehu iu kthye dhe një herë kësaj çështjeje, kur deklaroi: “Ne partia dhe populli, si një grusht jemi të bashkuar rreth KQ të partisë dhe shokut Enver... Ai që do të cenojë unitetin tonë do të marrë vetëm një përgjigje... përshtymën në fytyrë, grushtin hundëve dhe, po qe nevoja, edhe plumbin ballit”.<sup>49</sup>

### **Roli i Shqipërisë në Komisionin e Redaktimit**

Para Mbledhjes së 81 partive, vendet pjesëmarrëse dërguan në Moskë grupe që përgatitën dokumentet e mbledhjes së nëntorit, ky u quajt Komisioni i Redaktimit. Grupin shqiptar e kryesonte personi që kishte

<sup>47</sup> *Po aty*, fl. 218. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

<sup>48</sup> Sovjetikët nuk e kaluan në heshtje dënimin e Liri Belishovës dhe Koço Tashkos. Më 24 gusht 1961, në letërën e KQ të PKBS për KQ të PPSH, shkruhet: “Ne duhet ta themi hapur se, në qoftë se udhëheqësit shqiptarë do të guxojnë të ngrenë dorën kundër jetës së shokëve Liri Belishova, Koço Tashko dhe komunistëve internacionalistë të tjerë të ndershëm, ata asnjëherë, me asnjë justifikim dhe falsifikim nuk do të mund t’ia lajnë vetes këtë njollë të turpshme”. *Po aty*, F. 14/SKR, V. 1961, D. 3, fl. 174.

<sup>49</sup> *Po aty*, fl. 173. Letër e KQ të PKBS dërguar KQ të PPSH, 24 gusht 1961; shih dhe Mehmet Shehu, “Raport mbi direktivat e Kongresit IV të PPSH për Planin e Tretë Pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik dhe kulturor të RPSH”, në librin *Kongresi IV i PPSH, 13-20 shkurt 1961* (Përmbledhje materiale), Tiranë: Naim Frashëri, 1961, f. 262.

kryesuar dhe delegacionin e Bukureshtit, Hysni Kapo. Pritja e sovjetikëve për delegacionin shqiptar, sipas Kapos, ishte e ftohtë.<sup>50</sup> Përshtypja e Enver Hoxhës ishte se delegacionet e tjera, përveç kinezëve, nuk i kishin kushtuar rëndësi Komisionit, megjithatë, ai e porositi Kapon të mos lejonte askënd të hidhte akuza ndaj PPSH, “bjeru turinjve” – i shkroi, sepse, sipas tij, shqiptarët ishin “gjykatës të gabimeve të tjerëve dhe akuzues.”<sup>51</sup>

Çështjet që do të diskutoheshin në Komisionin e Redaktimit dhe që do të pasqyroheshin në projektdeklaratë, ishin: 1) Kriza e sistemit kolonial; 2) stabiliteti relativ i kapitalizmit; 3) kontradiktat mes vendeve kapitaliste; 4) çështja e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në pushtet në disa vende ish-koloniale; 5) rëndësia e luftës për paqe. Sipas Kapos, materiali që përmbante këto pika, i shpërndarë nga hungarezët, ishte përgatitur me qëllim të orientonte mënyrën e diskutimit.<sup>52</sup> Delegacioni shqiptar kërkoi leje nga Enver Hoxha për të biseduar me kinezët në lidhje me mbledhjen e nëntorit, duke i kujtuar se nëntori po afronte dhe nuk do të kishin rast më të mirë për të ditur “edhe mendimin e tyre për mbledhjen e ardhshme”.<sup>53</sup>

Tirana i kishte dërguar mesazhe mirëkuptimi Pekinit pesë muaj më parë. Gjatë kohës që Liri Belishova ndodhej në Kinë, Hoxha i dërgoi asaj një telegram me mesazh për kinezët, me anë të të cilit i këshillonte ata të merrnin pjesë në mbledhjen e Bukureshtit dhe se u shprehte pëlqimin e tij për artikujt antisovjetikë që botoheshin në shtypin kinez. Belishova, që nuk kishte dijeni për skenarët politikë të formësuar tashmë në mendjen e Hoxhës dhe bashkëpunëtorëve të ngushtë të tij, nuk e përcolli të plotë mesazhin, ajo nuk ua përmendi kinezëve mendimin e Hoxhës për artikujt.<sup>54</sup> Qëndrimi neutral i Shqipërisë në Bukuresht ishte më shumë në favor të kinezëve sesa sovjetikëve, të cilët kishin nevojë vetëm për mbështetje të drejtpërdrejtë. Në gusht, Kina dërgoi sinjalin e parë orientues për shqiptarët në lidhje me mbledhjen e nëntorit. Ambasadori kinez në Rumani i përcolli ambasadorit shqiptar mesazhin që në

<sup>50</sup> *AQSH*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 7, fl. 1. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 27 shtator 1960.

<sup>51</sup> *Po aty*, fl. 2. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 29 shtator 1960.

<sup>52</sup> *Po aty*, fl. 3. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 29 shtator 1960.

<sup>53</sup> *Po aty*, fl. 5/1. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 29 shtator 1960.

<sup>54</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 257. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

mbledhjen e nëntorit, Kina nuk do të ndryshonte pozicion. Ai lavdëroi gjithashtu qëndrimin e PPSH në Bukuresht dhe shprehu besimin se “ajo [PPSH] do të thotë fjalën e saj të drejtë në mbledhjen e nëntorit.”<sup>55</sup> Ambasadori kinez kërkoi gjithashtu të kishte kontakte më të afërta me ambasadorin shqiptar, të cilat u shtuan.

Marrëveshja për bashkëpunimin e delegacionit shqiptar me atë kinez në Komisionin e Redaktimit ishte bërë në nivelet më të larta të partive respektive. Hoxha i shkroi Kapos se Ten Hsiao Pini, kryetari i delegacionit kinez, ishte gati të bisedonte me të me hollësi dhe e këshilloi të gjente “rastin dhe mënyrën” për të biseduar me “shokët kinezë.”<sup>56</sup> Nga ana tjetër, Hoxha e vuri Kapon në dijeni për qëndrimet e palëve kryesore, të cilat ishin pasqyruar në dokumentin e kinezëve, që Kapo nuk e kishte lexuar ende. Sipas Hoxhës, delegacioni kinez kishte kritikuar ashpër sovjetikët, sidomos Hrushovin, për situatën ndërkombëtare të krijuar mes “armiqve” dhe vendeve socialiste dhe për marrëdhëniet e pabarabarta mes shtetit sovjetik dhe atij kinez. Hrushovi, sipas kinezëve, kishte shkëlur parimin e barazisë mes shteteve dhe partive, ai fliste mirë për imperializmin dhe i vinte në pozita jo të drejta çështjen e “armiqve” dhe “tonën.” Sovjetikët, sipas Hoxhës, vazhdonin me mbrojtjen e qëndrimeve të Hrushovit për çështjen kino-indiane, gabimet e Stalinit etj.<sup>57</sup>

Në takimin me delegacionin kinez, pala shqiptare mori mesazhin se çështja mes BS dhe Kinës kishte arritur aq larg sa nuk pritej asnjë rezultat pozitiv, sado i vogël. Kinezët ua bënë të qartë shqiptarëve që të luftonin së bashku në komision dhe në mbledhjen përfundimtare. Mbledhja e nëntorit, porositën kinezët, duhet të ishte vendi ku të hidheshin mbi tavolinë të gjitha çështjet. Më tej, të dy delegacionet bashkëpunuan ngushtë. “Qëndrimet tona do t’i kombinojmë me shokët kinezë,”<sup>58</sup> shkruante Kapo për Hoxhën. Për mbledhjen e parë të Komisionit të Redaktimit, shqiptarët ishin përgatitur të godisnin me ashpërsi, por Ten Hsiao Pini i këshilloi të mos përdornin terma si oportunistë, revizionistë,

<sup>55</sup> *Po aty*, F. 14/SKR, V. 1960, D. 691, fl. 27. Relacion i ambasadorit shqiptar në Bukuresht për një bisedë me ambasadorin kinez, 18 gusht 1960.

<sup>56</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 7, fl. 7. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 30 shtator 1960. Radiogrami është nënshkruar me një nga pseudonimet që Enver Hoxha mbante gjatë luftës: Shpati.

<sup>57</sup> *Po aty*, fl. 7. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 30 shtator 1960.

<sup>58</sup> *Po aty*, fl. 12-12/2. Radiogram i Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë për Enver Hoxhën, 3 tetor 1960.

por të rrëzonin pikëpamjet “e gabuara.”<sup>59</sup> Shqiptarët dhe kinezët kishin pikëpamje të njëjta për projektdeklaratën sovjetike dhe për mënyrën e trajtimit të çështjeve. Kinezët u thanë shqiptarëve çfarë duhet të synonin në komision: “Ekspozimin e qartë të pozitës së partisë sonë mbi çështjet, të futen në deklaratë çështjet tona të drejta dhe të hiqen formulimet e gabuara.” Nëse të tjerët do të kundërshtonin, atëherë shqiptarët dhe kinezët do të godisnin “në front të gjerë.” Ten Hsiao Pini u tha shqiptarëve se Mao Ce Duni nuk do të vinte në Mbledhjen e Moskës, ngaqë kinezët parashikonin që mbledhja nuk do të kishte një fund pozitiv. Ata parashikonin një luftë dhjetëvjeçare me Bashkimin Sovjetik.<sup>60</sup>

Delegacioni kinez dhe ai shqiptar kishin rënë dakord që, në seancën plenare, pala shqiptare të diskutonte një ditë më vonë, me qëllim që t’u jepte përgjigje atyre që mund të kritikonin fjalimin kinez.<sup>61</sup> Një ditë para nisjes së seancës plenare, 3 tetor, sovjetikët bënë një përpjekje të fundit për komunikim me shqiptarët, e ftuan Hysni Kapon për një drekë, por ai nuk pranoi, ngaqë, sipas tij, sovjetikët e kishin natyrë që, kur donin të bisedonin, të ftonin për drekë.<sup>62</sup> Delegacioni shqiptar diskutoi më 6 tetor. Fjalimi i Kapos, sipas vetë atij, u pëlqeu shumë kinezëve, sovjetikët “u bënë piper”, ndërsa bullgarët “e poshtër” qeshën dy herë gjatë fjalimit të tij. Gjithë vendet e “demokracive popullore”, të cilat qëndronin ftohtë me shqiptarët, nuk e pëlqyen fjalimin.<sup>63</sup> Rumunët i quajtën shpifje deklaratat e Kapos për Bukureshtin, por, sipas Kapos, diskutimi i rumunëve ishte “shumë i poshtër kundër Kinës”.<sup>64</sup> Çekoslovakët dhe polakët, sipas Kapos, folën “me aluzione”, kundër jugosllavëve “asnjë fjalë”, por nuk sulmuan as direkt.<sup>65</sup> Sipas Kapos, vendet socialiste evropiane vepronin të orkestruar nga Moska, përfshi dhe mënyrën se si vendosej radha për të folur. Mes vendeve socialiste Hoxha bënte dallim: bullgarët, polakët dhe rumunët duheshin kundërshtuar pa hezitim, sepse ata ishin, në fjalët e

<sup>59</sup> *Po aty*.

<sup>60</sup> *Po aty*, fl. 12-12/6. Bidesë e delegacionit shqiptar me Ten Siao Pinin, 2 tetor 1960.

<sup>61</sup> *Po aty*, fl. 12/2. Radiogram i Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë për Enver Hoxhën, 3 tetor 1960.

<sup>62</sup> *Po aty*, fl. 14. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 3 tetor 1960.

<sup>63</sup> *Po aty*, fl. 17. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 6 tetor 1960.

<sup>64</sup> *Po aty*, fl. 18. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 7 tetor 1960.

<sup>65</sup> *Po aty*, fl. 20/1. Radiogram i Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë për Enver Hoxhën, 7 tetor 1960.

Hoxhës, “brekë e bythë me sovjetikët”. Me çekët dhe hungarezët, Hoxha e këshilloi Kapon të ishte më i rezervuar, “në rast se nuk na sulmojnë”, sepse ata nuk ishin shumë aktivë kundër shqiptarëve.<sup>66</sup> Gjermanët, bullgarët, polakët dhe rumunët nuk flisnin fare me shqiptarët, as kur shkëmbeheshin rrugës.

Shqiptarët në Komisionin e Redaktimit ishin thjesht një levë e Kinës. Hoxha udhëzonte nga Tirana që Kapo ta mbronte “më direkt Partinë Komuniste Kineze.”<sup>67</sup> Ai e pranonte që sulmi kryesor i sovjetikëve dhe të tjerëve ishte kundër kinezëve, sepse rreziku më i madh për ta ishte PKK, dhe, nëse sovjetikët e mposhtnin PKK, çështja me Shqipërinë s’kishte ndonjë rëndësi për ta.<sup>68</sup> Kur donin të arrinin ndonjë kompromis për deklaratën, sovjetikët konsultoheshin me delegacionin kinez, e jo me atë shqiptar.<sup>69</sup> Retorika e delegacionit shqiptar drejtohej kundër “revizionizmit dhe oportunizmit”, në parim, pa emra, por qëllimi i vërtetë i delegacionit shqiptar, sipas Kapos, ishte të mbronte pikëpamjen kineze, të demaskonte sovjetikët dhe t’u kundërpërgjigjej atyre që kishin kritikuar ose kritikonin PPSH. Në të njëjtin radiogram, Kapo shkruante me krenari: “Pozita jonë në çështjet principiale dhe në mbrojtjen e Kinës doli e qartë.”<sup>70</sup>

Dokumenti që u përgatit nga Komisioni i Redaktimit, sipas Hoxhës, kishte shumë dobësi, sepse nuk sqaronte kush kishte devijuar nga vija marksiste-leniniste dhe pse u dënua Kina në Bukuresht. “Qëllimi i drejtë i joni”, shkruante Hoxha, që ishte sqarimi i çështjes së Kinës, “nuk arrihet.”<sup>71</sup> Shqiptarët ishin në dilemë për firmosjen e deklaratës, sepse, nëse nuk firmosnin, atëherë, sipas Hoxhës, triumfante Hrushovi, ndërsa, po ta firmosnin, nuk arrihej qëllimi kryesor i tyre dhe Kina mbetej e dënuar. Hoxha e udhëzoi Kapon të takohej me Ten Hsiao Pinin para mbledhjes, dhe variantet e diskutimeve për përmbajtjen e komunikatës që do të nxirrte Komisioni i Redaktimit të ishin këto: Të përpiqeshin për ta rregulluar komunikatën sipas pikëpamjes shqiptaro-kineze, të njiheshin

<sup>66</sup> *Po aty*, fl. 19/3-19/4. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 8 tetor 1960.

<sup>67</sup> *Po aty*, fl. 19/1. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 8 tetor 1960.

<sup>68</sup> *Po aty*.

<sup>69</sup> *Po aty*, fl. 29/1. Radiogram i Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë për Enver Hoxhën, 13 tetor 1960.

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 25-25/1. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 10 tetor 1960.

<sup>71</sup> *Po aty*, fl. 11. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 1 tetor 1960.

gabimet e sovjetikëve dhe të dënohej Bukureshti, mbledhja të mos niste me diskutimin e komunikatës, por me luftën kundër gabimeve.<sup>72</sup>

Gjithçka që u përgatit nga Komisioni i Redaktimit nuk kishte shumë rëndësi për shqiptarët, ata kishin shkuar në Moskë për konflikt, jo për debat. Ata donin që Hrushovi të pranonte ato që shqiptarët i konsideronin gabime të tij. Mbledhja e Komisionit të Redaktimit, me porosi nga Tirana, duhet të niste me luftën e delegacionit shqiptar kundër gabimeve të Hrushovit, dhe jo me diskutimin e deklaratës. Diskutimi i deklaratës paraprahe të bëhej përmes “demaskimit” të gabimeve. Mosarritjen e një marrëveshjeje deri në mbledhjen e nëntorit, Tirana e konsideronte dështim të manovrave të grupit të Hrushovit.<sup>73</sup>

Dështimi i vërtetë, sipas këndvështrimit të Moskës, në Komisionin e Redaktimit dhe Mbledhjen e Moskës, ishte dalja në dritë e përçarjes brenda Kampit Socialist, gjë që nuk ishte në interesin e saj. Sa i përket fitores që pretendonin drejtuesit e PPSH, ajo ishte e lidhur vetëm me pushtetin e tyre personal. Fjalimi i Enver Hoxhës në Moskë ishte një shfaqje besnikërie ndaj Kinës, të cilën e shikonte si burimin nga do të vinin ndihmat e kreditë që deri atëherë kishin ardhur nga Bashkimi Sovjetik. Më 13 tetor, Hoxha i shkroi Kapos që, para largimit nga Moska, të pyeste kinezët sesi do t’i trajtonin çështjet në mbledhjen e nëntorit, “në formë akademike apo do t’i japin zjarr punës”.<sup>74</sup> Hoxha ishte i qartë që fjalimi tij në Moskë do të ishte më i ashpri nga të gjithë, por ai ishte për një ndarje të rreptë me sovjetikët.<sup>75</sup> Dhe ashtu ndodhi.

### **Arsyet e përçarjes së Kampit Socialist dhe prishja e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik**

Hrushovi në vitin 1954, parashikonte që konflikti i Bashkimit Sovjetik me Kinën do të ishte i pashmangshëm. Sipas kujtimeve të tij, nëse Stalini do të kishte jetuar dhe ca, ky konflikt do të kishte shpërthyer më herët dhe do të kishte çuar në prishjen e plotë mes dy vendeve. Mao Ce Duni, gjithnjë sipas Hrushovit, e kishte të vështirë ta pranonte faktin që lëvizja komuniste ndërkombëtare të udhëhiqej nga një parti komuniste

<sup>72</sup> *Po aty*, fl. 11-11/1. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 1 tetor 1960.

<sup>73</sup> *Po aty*.

<sup>74</sup> *Po aty*, fl. 31/1. Radiogram i Enver Hoxhës për Hysni Kapon, 13 tetor 1960.

<sup>75</sup> *Po aty*.

tjetër veç asaj kineze.<sup>76</sup> Hrushovi përmend si shkak të konfliktit të mundshëm dhe cilësitë personale të Maos, i cili, sipas tij, nuk konsideronte njeri të barabartë me veten, gjë që do të thoshte se ai mund të shoqërohej vetëm me njerëz që e pranonin supremacinë e tij. Pas vizitës në Kinë (1959), Hrushovi raportoi në Presidiumin e KQ të PKBS dhe theksoi se marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Kinën kishin “një perspektivë të zymtë.”<sup>77</sup> Në mbledhjen e Bukureshtit, sipas Hysni Kapos, Hrushovi u tha kinezëve të mos pretendonin rolin e komisarit në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, por t’iu nënshtroheshin vendimeve kolegjiale të saj.<sup>78</sup> Në Komisionin e Redaktimit, kinezët nuk pranuan që në projektdeklaratë të përmendej Hrushovi<sup>79</sup> dhe Kongresi XX e XXI i PKBS. Kinezët kundërshtuan duke thënë se vendimet e një partie nuk duhet të jenë të detyrueshme për partitë e tjera.<sup>80</sup>

Kina nuk e kishte, por e dëshironte, statusin ndërkombëtar që kishte Bashkimi Sovjetik. Në dekadën e parë të pushtetit komunist, nuk ishte e përgatitur për një rol ndërkombëtar në konkurrencë me dy superfuqitë. Ajo nuk kishte realizuar ende ribashkimin kombëtar dhe legjitimiteti i revolucionit të saj mbetej i dyshimtë, për sa kohë që ekzistonte një regjim alternativ, i vendosur në Formosa (Tajvan), dhe i mbështetur nga SHBA. Kina synonte ta përdorte lëvizjen komuniste ndërkombëtare për t’iu kundërvënë pengesës së saj kryesore, SHBA.<sup>81</sup>

Për të realizuar synimet e saj, Kina kishte nevojë të arrinte me Bashkimin Sovjetik katër objektiva: investime të konsiderueshme dhe ndihmë thelbësore për ndërtimin e një sistemi strategjik të armëve bërthamore; hapësirë më të madhe vendimmarrëse në lëvizjen komuniste ndërkombëtare; mbështetje nga sovjetikët në politikën e jashtme në lidhje

<sup>76</sup> Nikita Hrushov, *Kujtime*, përkthyer nga Nikolla Sudar, Tiranë: SHB 55, 2006, f. 215.

<sup>77</sup> *Po aty*, f. 247.

<sup>78</sup> *AQSH*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 8, fl. 22. Raport mbi zhvillimin e punimeve në mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore.

<sup>79</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 7, fl. 29/2. Radiogram i Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë për Enver Hoxhën, 13 tetor 1960.

<sup>80</sup> *Po aty*, fl. 33. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 19 tetor 1960.

<sup>81</sup> Donald S. Zagoria, “The Widening Gulf Between Mao and Khrushchev”, *The Reporter*, April 25, 1963, pp. 39. Adresa (16 maj 2016): <http://www.unz.org/Pub/Reporter-1963apr25-00038?View=PDF>

me Tajvanin, Indinë, dhe pjesë të tjera të Azisë; ndryshim radikal në strategjinë sovjetike që do të çonte në nxitjen dhe mbështetjen e luftërave revolucionare në gjithë vendet e pazhvilluara, gjë që do t'i detyronte amerikanët të ndryshonin drejtimin e fuqisë së tyre dhe do të çonte në dobësimin e saj. Sovjetikët nuk kishin pranuar të përmbushnin asnjë nga kërkesat e Kinës, sepse kjo do të pengonte në ngritjen e standardit të jetës së qytetarëve sovjetikë, gjë që ndoshta do të rriste pakënaqësinë në popull, mund të çonte në luftë me SHBA dhe mund të dobësonte, në mos ta humbiste fare, pozicionin superior të Moskës në lëvizjen komuniste botërore.<sup>82</sup>

Në Komisionin e Redaktimit, Ten Hsiao Pini shprehte pikërisht zemërimin e Kinës në lidhje me ekonominë dhe bombën atomike,<sup>83</sup> kur i tha delegacionit shqiptar se, “meqenëse janë ekonomikisht të fortë, sovjetikët mendojnë se i shohin drejt çështjet”. Por, ai kishte bindjen se do të vinte dita që dhe “ne do kemi edhe çelnik, edhe hekur, edhe bombën atomike dhe padyshim shumë do binden që ne nuk jemi dogmatikë si thotë Hrushovi.”<sup>84</sup>

Kur u bind që mosmarrëveshjet kino-sovjetike shkonin drejt përçarjes së Kampit Komunist, Shqipëria bëri lëvizjen e saj, më shumë pragmatike, sesa ideologjike. Shqipëria nuk bëri asnjë lloj debati publik me Bashkimin Sovjetik, siç bëri Kina, sepse Tirana nuk kishte as pretendime për rol udhëheqës në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe as njerëz të aftë për beteja ideologjike. Drejtuesit e PPSH kishin filluar të mendonin për distancimin nga Bashkimi Sovjetik që më 1957.<sup>85</sup> Në Bukuresht ata qëndruan neutralë nga pasiguria se mos konflikti kino-sovjetik

<sup>82</sup> Po aty.

<sup>83</sup> Në një raport nga Varshava (tetor 1960), i Ngarkuari me punë në Poloni, Jovan Andoni, shkruante se pas mbledhjes së Bukureshtit në Poloni thuhej hapur se qeveria kineze do luftë dhe se i ka kërkuar, me këmbëngulje, armë atomike Bashkimit Sovjetik. *AQSH*, F. 14/STR, V. 1960, D. 682, fl. 14. Informacion mbi disa çështje lidhur me mbledhjen e Bukureshtit.

<sup>84</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 7, fl. 23/4. Radiogram i Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë për Enver Hoxhën, 9 tetor 1960.

<sup>85</sup> Në takimin me Hrushovin, 12 nëntor 1960, Mehmet Shehu deklaroi që keqësimi i marrëdhënieve kishte nisur më 1957 (*Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 30, fl. 210). Në mbledhjen e Byrosë, 28-29 gusht 1960, Koço Tashko deklaroi se grindjet me BS kishin nisur që më 1957 dhe ai nuk dinte gjë (*Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 204).

përfundonte me pajtimin e palëve.<sup>86</sup> Situata ndryshoi kur Kina u dha garanci shqiptarëve me qëndrimin kundërshtues që do të mbante në mbledhjen e nëntorit (1960) dhe kërkoi bashkëpunim me ta. Më e rëndësishmja, kinezët u ofruan përkrahje ekonomike.<sup>87</sup>

Çështjet ideologjike, marksizëm-leninizmi, revizionizmi, kulti i individit, apo afrimi i Moskës me Beogradin, pavarësisht ndikimit, nuk kishin peshën kryesore, siç propagandonte Tirana zyrtare në vendimin e PPSH për prishjen me PKBS. Ato ishin argumente të nevojshme dhe të besueshme për publikun, se të gjitha kishin një bazë të vërtetë, por nuk ishin çështjet kyç që çuan në prishjen e marrëdhënieve.

Udhëheqja kishte treguar më herët që nuk nguronte t'i shkelte parimet. Ajo ishte e njohur në gjithë botën komuniste për kritikën e saj ndaj Jugosllavisë, por, kur Moskës u afrua me Beogradin, Tirana e zbuti qëndrimin e saj. Në fillim drejtuesit e PPSH u treguan emocionalë, sepse ishin të sigurtë në urrejtjen për Jugosllavinë, dhe e kundërshtuan afrimin e Moskës, por dy ditë më vonë Hoxha dhe bashkëpunëtorët e tij bënë autokritikë.<sup>88</sup> Shqipëria i përmirësoi marrëdhëniet me Jugosllavinë, madje i vazhdoi ato edhe pas prishjes me Bashkimin Sovjetik. Edhe sulmet e Hrushovit ndaj Stalinit, Hoxha nuk i priti mirë, por emri i Stalinit u hoq nga retorika publike, pavarësisht se qëndroi si emërtim qyteti apo kombinati. Kështu ndodhi edhe në vendet e tjera. Çekosllovakia mund të konsiderohej vërtetë antistaliniste, por në Pragë Stalinit i ishte ngritur monumenti më i madh në botë, 18 000 tonë mermer, i cili u prish vetëm gjatë valës së dytë të destalinizmit të ndërmarrë nga Hrushovi në Kongresin XXII të PKBS (1962).<sup>89</sup> Hoxha kishte treguar se i bindej Moskës, edhe kur ajo kryente veprime që atij nuk i pëlqenin; ai nuk e kishte problem të tregohej hipokrit, kur ia lypte nevoja. Deri atëherë, ai kishte eliminuar disa nga bashkëpunëtorët e tij,

<sup>86</sup> Këtë dyshim Enver Hoxha e shprehu në një shkëmbim replikash me Liri Belishovën në mbledhjen e Byrosë, 28-29 gusht 1960 (*Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 279).

<sup>87</sup> *Po aty*, F. 14/SKR, V. 1960, D. 507, fl. 6-7. Proceverbali i takimit të Enver Hoxhës me përfaqësuesit e ambasadave dhe legatave shqiptare në botë, 29 dhjetor 1960.

<sup>88</sup> Ana Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e '56-ës*, Tiranë: Infbotues, 2015, f. 34-35.

<sup>89</sup> Ivo Duchacek, "Czechoslovakia: The Past Reburied", *Problems of Communism*, May 1962 Issue - 11, pp. 22. Adresa (30 prill 2016): <http://www.unz.org/Pub/ProblemsCommunism-1962may-00022>

nga Koçi Xoxe (1948), Tuk Jakova e Bedri Spahiu (1955), disa të tjerë ndërmjet, e deri te Liri Belishova e Koço Tashko. Hipokrizia e Enver Hoxhës, i cili në kujtimet e Hrushovit shfaqet “thjesht një bandit”,<sup>90</sup> nuk njihete kufij. Më 1944, ai urdhëroi vrasjen e Mustafa Gjinishit, figurë e njohur komuniste, dhe, pas kryerjes së aktit, urdhëroi që, në nderim të tij, njësitë partizane ta mbanin flamurin tre ditë në gjysmështizë.<sup>91</sup>

Arsyeja e vërtetë e prishjes me sovjetikët ishte pasiguria e Enver Hoxhës për pushtetin e tij. Në mbledhjen e Byrosë, 28-29 gusht 1960, Liri Belishova u akuzua, mes të tjerash, se kishte synuar të zinte postin e Enver Hoxhës, Mehmet Shehut, ose Hysni Kapos, dhe Hoxha u shpreh “plotësisht dakord” me akuzat.<sup>92</sup> Hoxha i trembej faktit që sovjetikët mund të përdornin Belishovën ose dikë tjetër kundër tij. Pasiguria e Hoxhës për pushtetin e kishte origjinën te disa ngjarje të vitit 1957.

Pas ekzekutimit të Dali Ndreut dhe Liri Gegës (1956), në maj 1957, u arratis në Jugosllavi Panajot Plaku, anëtar i KQ të PPSH dhe deputet në Kuvendin Popullor, i trembur për jetën e vet, ndërkohë që vëllai i tij, Kalo Plaku, ishte ekzekutuar. Ai i shkroi Hrushovit një letër, ku i kërkonte të ndërhynte për rrëzimin e Enver Hoxhës nga pushteti. Hrushovi ia përcolli letrën KQ të PPSH dhe i pyeti drejtuesit e tij për mundësinë e kthimit të Plakut në Tiranë ose vendosjen e tij në Moskë. Ata nuk pranuan asnjërin variant, madje i thanë Hrushovit, sipas Hoxhës, se, nëse Plaku kthehej në Shqipëri do të ekzekutohej, ndërsa, nëse pranohej në Bashkimin Sovjetik, kjo do të rrezikonte marrëdhëniet mes dy vendeve. Pas kësaj, sipas Hoxhës, Hrushovi u tërhoq. Veç kësaj, Hrushovi e kishte kritikuar udhëheqjen shqiptare për vrasjen e Dali Ndreut dhe Liri Gegës, e cila, sipas tij, kishte qenë shtatzënë, gjë që Hoxha e kishte mohuar.<sup>93</sup>

Këto ngjarje duket se kanë qenë pika e kthesës, po të kemi parasysh kujdesin me të cilën e shikonin simbolikën drejtuesit e PPSH. Gjatë

<sup>90</sup> N. Hrushov, *Kujtime ...*, f. 208.

<sup>91</sup> *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës: Plenumi i 2-të i KQ të PKSh: Berat, 23-27 Nëntor 1944* (Dokumente), përgatitën për botim Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1995, f. 90, 128.

<sup>92</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 390. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

<sup>93</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 42-43. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960; shih J. Birch, “Albania – The Reluctant Puppet ...”, f. 281.

qëndrimit të Liri Belishovës në Moskë, pas kthimit nga Kina, Rrapo Dervishi dhe Belishova debatuan në plenumin e korrikut (1960) për radhën e dollive në një drekë me sovjetikët. Dervishi thoshte që dollia për Hoxhën ishte ngritur pas disa dollish të tjera dhe kjo ishte, sipas tij, shenjë e ftohjes së sovjetikëve.<sup>94</sup> Enver Hoxha braktisi takimin me Hrushovin, më 12 nëntor 1960, vetëm se Hrushovi nisi të tregonte diçka që i kishte ndodhur në një takim me kryeministrin britanik Harold Makmilanin. Sa u përmend Makmilani, duke e marrë këtë si një krahasim personal të padëshiruar me politikanin konservator britanik, Hoxha e la takimin në mes.<sup>95</sup>

Pas mbledhjes së Bukureshtit, dyshimet e udhëheqjes shqiptare u shtuan. Mehmet Shehu pretendonte se, kur kishte qenë i shtruar në spital në Moskë, i kishte shkuar për vizitë Kosigini, me mendimin se “unë mos vihesha kundra shokut Enver”. Pastaj sovjetikët, sipas Shehut, ishin përpjekur me Gogo Nushin, me Rita Markon dhe, në fund, me Liri Belishovën.<sup>96</sup> Në kohën e Komisionit të Redaktimit, më 20 tetor 1960, sovjetikët kishin provokuar, sipas Hysni Kapos, gjeneralët shqiptarë. Malinovski kishte kërkuar të takohej me Petrit Dumen, gjeneral, i cili ndodhej në Moskë, por nuk ishte lejuar nga Kapo.<sup>97</sup> Hoxha dyshonte se sovjetikët synonin të përdornin ushtrinë shqiptare kundër tij, nisur dhe nga një bisedë e ambasadorit sovjetik në Shqipëri, i cili kishte pyetur disa gjeneralë shqiptarë se kujt i qëndronte besnike ushtria. Këto ai ia tha Hrushovit, në takimin që la në mes, por, pavarësisht se udhëheqësi sovjetik i konsideroi “pallavra”,<sup>98</sup> ato ishin të mjaftueshme që Enver Hoxha të mos kishte më besim në miqësinë e Bashkimit Sovjetik.

<sup>94</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 22, fl. 261. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 29-31 gusht 1960.

<sup>95</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 30, fl. 225. Regjistrim i bisedës së delegacioneve të PKBS dhe PPSH, Moskë, 12 nëntor 1960.

<sup>96</sup> *Po aty*, F. 14/OU, V. 1960, D. 2, fl. 166. Procesverbal i mbledhjes së plenumit të KQ të PPSH, 11-12 korrik 1960. Diskutim i Mehmet Shehut.

<sup>97</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 7, fl. 37. Radiogram i Hysni Kapos për Enver Hoxhën, 21 tetor 1960.

<sup>98</sup> *Po aty*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 30, fl. 215-216. Regjistrim i bisedës së delegacioneve të PKBS dhe PPSH, Moskë, 12 nëntor 1960.

*S u m m a r y*THE SPLIT OF THE COMMUNIST BLOCK AND THE BREAK OFF ALBANIA'S  
RELATIONS WITH THE SOVIET UNION

Until 1960, the Soviet Union was Albania's greatest ally, the guarantor of its sovereign security, and almost the official financier of the Tirana regime. In 1961, Khrushchev publicly criticized the ALP leadership, even called for its overthrow, and soon broke diplomatic relations with Albania. This was the first time that the crack in Albanian-Soviet relations became public, until then everything had happened outside the public eye. This article analyzes exactly what happened behind closed doors, from the Bucharest Summit (June 1960) at the Moscow Summit (November 1960), based on original documents, such as letters, telegrams, and minutes. The article answers questions, why Albania remained neutral in Bucharest in the Moscow-Beijing clash, why it became the strongest critic of the Soviet Union in November, and what was the origin of the conflict between them.